




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK.nr.523/2023**

**Datë: 27 nëntor 2023**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe Rregullores Nr.02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra e Gjyqtarëve Porotë, në takimin 317-të, të mbajtur më 27 nëntor 2023, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e z. Donjet Doblbara, gjyqtar porot në Gjykatën Themelore në Gjakovë, i cili ka kërkuar nga KGJK që t'ia lejoj ushtrimin e funksionit të Zyrtarit Ligjor pranë Kompanisë Kosova Dept Collection Agency SHPK, me kufizime, ndërsa pozitën e gjyqtarit porot pa kufizime.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 11 tetor 2023, ka pranuar nga z. Donjet Doblbara, kërkesën për sqarimin e statusit të gjyqtarit porot pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, gjegjësisht nëse paraqet konflikt interesi angazhimi i tij si zyrtar ligjor pranë Kompanisë Kosova Dept Collection Agency SHPK, me pozitën e gjyqtarit porot në Gjykatën Themelore në Gjakovë, i emëruar nga KGJK, me vendimin KGJK.nr.327/2023, të datës 28 korrik 2023, si dhe mundësinë e ushtrimit të këtyre profesioneve, në bazë të kufizimeve të përcaktuara nga KGJK.

Pas shqyrtimi dhe analizimit të kërkesës së tij, KGJK vlerësoi se në rastin konkret ekziston mundësia që z.Doblbara gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve pashmangshëm të bie në kontakt me gjyqtarët e gjykatës, si dhe një veprim i tillë bien ndesh edhe me parimet bazë të etikes profesionale, për çka edhe refuzoj kërkesën e të njëjtit. Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Z. Donjet Doblbara;
- Gjykatës Themelore në Gjakovë;
- SKGJK dhe Arkivit